



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

URDHËR

NR. 7641, DATË 5/07/2018

PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË MARRËVESHJES PËR ZBATIMIN E MASËS SË SHMANGIES DHE/OSE NDËRMJETËSIMIN

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 58, pika 4 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Elementët të marrëveshjes midis palëve për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale dhe/ose ndërmjetësimin (më poshtë “Marrëveshja”) janë:

- a) palët e marrëveshjes;
- b) objekti i marrëveshjes;
- c) parimet nga të cilat udhëhiqet marrëdhënia ndërmjet palëve;
- ç) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- dh) programin e ndërmjetësimit dhe rregullat e zbatimit të tij;
- e) përshkrimin e pasojave të mospërmbushjes së detyrimeve.

2. Palët në marrëveshjen për zbatimin e masës së shmangies janë:

- a) i mituri, i cili duhet të japë pëlqimin personalisht ose nëpërmjet kujdestarit/përfaqësuesit ligjor apo procedural. Gjatë bisedimeve për shpjegimin e kuptimit të marrëveshjes dhe pasojave të saj dhe për dhënien e pëlqimit për lidhjen e marrëveshjes, i mituri shoqërohet nga përfaqësuesi i tij ligjor, i cili nënshkruan bashkë me të. Në rast se përfaqësuesi ligjor konsiderohet i papërshtatshëm në raport me të miturin ose me procesin, i mituri do të shoqërohet për dhënien e pëlqimit për lidhjen e marrëveshjes nga një përfaqësues procedural i caktuar nga organi kompetent.
- b) prokurori i çështjes, i cili kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve vendos mosfillimin e procedimit penal ose pushimin e tij për të miturin e akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

3. Mbrojtësi i të miturit dhe psikologu marrin pjesë në bisedimet për lidhjen e marrëveshjes për vendosjen e masës së shmangies.

4. Objekti i marrëveshjes përcakton në mënyrë të detajuar:

- a) përshkrimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale;
- b) llojin e masës së shmangies;
- c) arsyeja dhe qëllimi për të cilin prokurori i jep të miturit këtë masë;
- ç) mënyra e zbatimit të masës nga i mituri.

5. Marrëveshja duhet të mbajë në konsideratë parimet e mëposhtme:

- a) interesi më i lartë të të miturit që vlerësohet i lidhur me:
 - i) hartimin në një gjuhët të kuptueshme për të miturin;
 - ii) respektimin e mendimit të të miturit;
 - iii) mbrojtjen dhe kujdesin e të miturit për të garantuar mirëqënien e tij;
 - iv) shmangien e viktimizimit të dytë/të përsëritur të të miturit;
 - v) mirëbesimin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të të miturit;
- b) vlerësimin e profilit të të miturit që vlerësohet i lidhur me:
 - i) rrezikshmërinë e veprës penale të kryer;
 - ii) dënimin e parashikuar për atë vepër;
 - iii) moshën e të miturit;
 - iv) shkallën e fajësisë;
 - v) dëmin e shkaktuar;
 - vi) efektin psikologjik për shkak të ndjekjes penale;
 - vii) qëndrimin e të miturit në lidhje me veprën penale të kryer dhe empatinë ndaj viktimës;
 - viii) sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale; si dhe
 - ix) raportin e vlerësimit individual;
- c) qasjen ndërsektoriale në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të të miturit;
- ç) shprehjen e vullnetit të lirë dhe të plotë të palëve;
- d) ekuilibrin e drejtë dhe të sigurt të interesave private e personale me interesin publik.

6. Masat e shmangies dhe ose /ndërmjetësimit duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me moshën dhe me nevojat e të miturit autor dhe viktimë që garantojnë dhe synojnë mbrojtjen, edukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre,

7. Marrëveshja parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas llojit dhe specifikës së masës së shmangies të negociuar ndërmjet palëve. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies dhe /ose ndërmjetësimit, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose/dhe mendor.

8. Programi i ndërmjetësimit hartohet dhe ndiqet nga ndërmjetësi i zgjedhur nga palët.

9. Programi i ndërmjetësimit mban në konsideratë:

- a) natyrën e veprës penale;
- b) historinë e të miturit;
- c) mundësinë e kthimit të raporteve normale midis të miturit autor dhe viktimës;

mundësinë e zvogëlimit të dëmit të viktimës;

d) mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri;

dh) nevojën e përmirësimit të marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

10. Programi i ndërmjetësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e të miturit autor të veprës penale dhe viktimës. Me pëlqimin e palëve, në programin e ndërmjetësimit mund marrin pjesë përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij.

11. Programi i ndërmjetësimit mund të përfshijë edhe ndërmjetësimin familjar, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin autor, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë rast programi i ndërmjetësimit përfshin mënyrën e kompensimit të dëmit dhe përmbushjes së detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë autorin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

12. Marrëveshja përmban përshkrimin e pasojave të mospërmbushjes së detyrimeve. Nëse i mituri nuk përmbush detyrimet në marrëveshjen punonjësi i shërbimit të provës ose ndërmjetësi informon me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes dhe situatën personale të të miturit.

13. Për procedurën që ndiqet për mospërmbushjen e kushteve dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja zbatohen parashikimet e nenit 72 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

14. Ngarkohet struktura përgjegjëse për çështjet e drejtësisë për të miturit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Etilda Gjonaj (Saliu)

